



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:030107

Datë: 01.06.2022

Numri i dokumentit: 03084598

**P. nr. 28/2021**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit L. P. nga fshati D., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/II.nr. 200/2021 të datës 12.02.2021, në shqyrtimin e dytë të mbajtur më 23.03.2022, në prezencën e prokurorit të shtetit Sadri Alija, të dëmtuarit V. Ll., të akuzuarit L. P., së bashku me mbrojtësin e tij Ramadan Paçarizi, avokat në Malishevë, **më 28 mars 2022 nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

### **A K T G J Y K I M**

I akuzuari **L. P.** nga i ati B., e ëma H., e lindjes B., i lindur me ....., në fshatin D., Komuna e Malishevës, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i pa martuar, student saldues në Z., punon në biznesin e tij "I. S." në fshatin D., i gjendjes së mirë ekonomike, me parë i pa dënuar, me numër personal ....

### **ËSHTË FAJTOR**

Më datën 22.01.2021, rreth orës 17:25/h, në Malishevë, saktësisht në hyrje të Malishevës, në rrugën "R.-M.", me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër të dëmtuarit V. Ll., në atë mënyrë që derisa i pandehuri dhe i dëmtuari ishin duke lëvizur me veturat e tyre, për një moment i pandehuri, ka tejkalar të dëmtuarin, e ndal veturën, e ka ndalur edhe të dëmtuarin, i cili po sa hap dritaren e veturës, i pandehuri e fyen me fjalë dhe e sulmon fizikisht duke e goditur me shuplaka në fytyrë, e me pastaj largohet nga aty, nga ky sulm i dëmtuari nuk pëson lëndime trupore të dukshme.

- me çka ka kryer veprën penale sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 3,4,7, 17,38,39,40,43,69,70,184 par.1 të KPRK-së, dhe neneve 248 dhe 365 të KPPRK-ës, të akuzuarin e,

**G J Y K O N**

Të akuzuarin **L. P.** e dënon me dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) euro, të cilin dënim është i detyruar ta paguaj brenda afatit prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyruar.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 30,00 €, për shpenzimet e ekspertizës mjeko ligjore në shumën prej 20 €si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari V.LI. nga fshati S., Komuna e Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

### **Arsyetimi**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PP./II.nr. 200/2021, të datës 12.02.2021, kundër të akuzuarit L. P. nga fshati D., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin të dytë me dt. 23.03.2022, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për t'ia pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit L. P., konsideroj se janë plotësuar kushtet ligjore të paraparë nga neni 248 të KPRK-së, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pasi ka kuptuar natyrën pasojat dhe benifitet e pranimit të fajit, si dhe pas sqarimit të mjaftueshëm nga ana e mbrojtësit të tij dhe propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovoj.

Pra me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike si në dispozitivin, e aktakuzës se i akuzuari ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 të KPRK-së, po ashtu të njëjtin ta shpall fajtor ta dënoj konform ligjit duke marrë parasysh si rrethanë lehtësues pranimin e fajit, si dhe rrethanat rëndues nëse gjen gjykata, si i dhe i njëjti të obligohet në pagimin e shpenzimeve procedurale.

I dëmtuari V.LI., deklaroi se kërkoj që të zbatohet ligji ndaj të akuzuarit pasi që ditën e veprës penale kam qenë në situatë shumë të rëndë, ku aty kame qenë më nënë bashkëshorten tim dhe fëmijët e mijë, konsideroj se nuk është e lehtë se dikush më të

goditur në prezencën e nënë gruas tim dhe fëmijëve të mijë pa ndonjë arsye. Këtë çështje do ta ndjekë edhe në konteste civile, më padi civile.

Mbrojtësi i të akuzuarit L. P. av. Ramadan Paçarizi deklaroi se pas konsultimit me të mbrojturin tim, i njëjti e pranon fajësinë në lidhje me veprën penale e cila i vihet në barrë nga a organi i akuzues i njëjti edhe pendohet për veprën penale në fjalë. Më që i njëjti e ka pranuar fajësinë në këtë fazë të procedurës penale, kërkojmë nga gjykatë që gjatë shqiptimit dhe matjes së dënimit të merren si rrethana lehtësues përveç pranimi të fajësisë edhe kërkimi falja ndaj këtu të dëmtuarit, se i njëjti nuk ka ra ndesh asnjë here në të kaluarën më ligjin, sjellja e tij korrekte në gjykatë, dhe ndaj të njëjtit ti shpall një dënim sa më të butë të mundshëm në kuadër të dispozitave ligjore,

I akuzuari L. P., deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, të dëmtuarit i kërkoj falje, kjo është hera e parë që kam kryer vepër penale, i premtoj gjykatë se nuk kam me përsërit vepër tjetër penale, sa i përket më të dëmtuarin nga dita e veprës penale nuk kemi pasur problem, ngase të njëjtin nga ajo ditë nuk e kamë parë.

Unë L. P., heqë dorë nga parashtresa të dorëzuar në këtë gjykatë sa i përket kundërshtimit të provave dhe hedhjes së aktakuzës.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin e dytë u vërtetua se ai me datë, kohë dhe vend si në diapozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Raporti fillestar i incidentit nr. ... i datës 22.01.2021; procesverbal i marrjes në pyetje të dëmtuarin V. Ll. nr. ... datës 22.01.2021; Procesverbal i marrjes në pyetje të dyshuarit L. P. nr.2... datës 22.01.2021;raporti i policit D. K. ID.#... nr. rastit ... datës 22.01.2021; Q.K.M.F. M., raport mjekësor nr. ... i dt. 22.01.2021 për të dëmtuarin V. Ll.; ekspertiza mjeko-ligjore e Dr. F. D. MD FMD, si dhe shkresat tjera te lendes.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarinimin e pranimi të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarinimin e pranimi të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69,70, të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese ka marr faktin se i pandehuri ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, sjelljen korrekte e të akuzuarit, të njëjtën e pranojë në mënyrë vullnetare pa presion, këtë e ka kryer për herën e parë, i ka kërkuar falje të dëmtuarit, i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëritë vepër tjetër penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori vetëm faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me gjobë në shumën prej treqind (300) euro, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**  
**P. nr. 28/2021, datë 28 mars 2022**

**Zyrtarja ligjore,**  
**Albane MORINA**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Njazi MORINA**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.